



Prishtinë, 23 dhjetor 2016
Kodi i ZRRE-së: V_878_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 15 , dhe Dispozitat e Nenit 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 8 Paragrafët 4, 8 dhe 9 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081);
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) të datës 17.10.2016 për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit: Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike 2017-2026;

në seancën e mbajtur me datë 23.12.2016, nxori këtë:

VENDIM

I. MIRATOHET dokumenti **Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike 2017-2026**

Arsyetim

- 1) Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 17.10.2016 ka pranuar kërkesën për aprovim të dokumentit Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike 2017-2026 nga KOSTT Sh.A. Dokumenti është zhvilluar nga KOSTT duke u bazuar në Ligjin për Energji (L05/081).
- 2) ZRRE ka pranuar edhe komentet nga MZHE si dhe ka dhënë komentet e veta në formë të shkruar të cilat komente janë përfshirë, apo janë sqaruar çështjet e ngritura. Pas përfshirjes së komenteve të arsyeshme (dy herësh), dokumenti është dërguar sërish me datë 12.12.2016, si version final për aprovim në ZRRE.
- 3) Bazuar në Nenin 8 të Ligjit për Energjinë, ZRRE konsideron se dokumenti i përmbush kriteret për miratim, dhe duke marrë parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje të vendimit, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi duke miratuar dokumentin Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike 2017-2026.



- II. Duke pasur parasysh ndikimin e parametrave të ndryshëm të bilancit në përcaktimin e tarifave, ZRRE mban të drejtën që gjatë shqyrtimeve tarifore të përshtatë të dhënat që përmban Bilanci afatgjatë i energjisë elektrike 2017-2026.
- III. Në zbatim të nenit 42, paragrafi 2.3 të Ligjit Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, ZRRE do të monitoroj implementimin e Bilancit afatgjatë të Energjisë elektrike 2017-2026 për të verifikuar realizimin e të dhënave dhe informatave të paraqitura në Bilanc.
- IV. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Vendimit i bashkëngjitet dokumenti:


- **Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike 2017-2026**

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së


Krenar Bujupi, u.d. kryesues


Arsim Janova, anëtar


Besim Sejfiqaj, anëtar